



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21 regjistër (JR)  
Datë 24.04.2019

Nr. 23 i vendimit  
Datë 25.09.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 25.09.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 21/2019 (JR), datë 24.04.2019, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 103, datë 05.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi

ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Donika Prea, dhe shkarkimin e saj nga detyra, dëgjoji subjektin e rivlerësimit dhe avokaten e saj Blerina Dodaj, të cilat gjatë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Donika Prea (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
  - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
  - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës” për subjektin e rivlerësimit.
5. Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim “GPPP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga vetë subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar

pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe GPPP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 103, datë 05.02.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 103, datë 05.02.2019, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, me funksion prokurore.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

*8.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin, me burime financiare të ligjshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.*

*8.2. Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë konkludoi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.*

*8.3. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”, pasi ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 103, datë 05.02.2019, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

10. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi t'i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

○ *Ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela.*

11. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

*Shkaqe që lidhen me kontrollin e pasurisë*

12. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit (*vetting* dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues. Referuar deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratës *vetting*, rezultateve të hetimit administrativ, akteve të administruara dhe përfundimeve të arritura nga Komisioni, Komisioneri Publik, në rastin konkret, konstaton se subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit që, në kuptim të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, do ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë e, për pasojë, të sillte konfirmimin në detyrë. Nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, Komisioneri Publik vlerësoi se në analizën financiare, në zërin e të ardhurave, duhen konsideruar vetëm ato të ardhura për të cilat provohet (i) burimi i ligjshëm i krijimit, (ii) deklarimi i saktë dhe (iii) pagesa e detyrimeve tatimore.

**12.1 Komisioneri Publik, pasurinë "apartament banimi me sip. 95,6 m<sup>2</sup>, fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.10.2012", e ka ankuar në drejtim të vlerësimit të këtyre elementeve: (i) mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006; (ii) mundësia për mbulimin e pagimit të kësteve për pasurinë nga të ardhurat e vitit 2007; (iii) mundësia e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit Gj.P., për të dhënë hua në shumën 15.000 euro; si dhe (iv) mundësia e subjektit të rivlerësimit për të shlyer me burime të ligjshme huan e deklaruar.**

**12.2** Sipas analizës së kryer nga Komisioneri Publik lidhur me mundësinë financiare për të realizuar kursimet e deklaruara në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2006, subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për një diferencë negative prej 285.131 lekësh.

**12.3** Lidhur me mundësinë e subjektit për të mbuluar pagesën e kësteve të apartamentit nga të ardhurat e vitit 2007, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk mbulojnë

me të ardhura të ligjshme pagesën e shumës prej 1.100.000 lekësh, të deklaruara si të paguara në vitin 2007, me burim të ardhura nga paga, për një diferencë negative prej 450.240 lekësh.

**12.4** Lidhur me huan e marrë nga z. Gj.P., Komisioneri Publik pretendoi se duhet të konsiderohen vetëm ato të ardhura për të cilat provohet ligjshmëria e krijimit dhe pagimit të detyrimit tatimor për to. Komisioneri Publik pretendoi se dokumentet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit Gj.P. për të dhënë huan.

**12.5** Lidhur me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të shlyer huan 15.000 euro, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet e vitit 2008, përfshirë dhe shlyerjen e deklaruar të huas për vlerën -405.697 lekë dhe gjithashtu nuk është shpjeguar bindshëm burimi i të ardhurave të huadhënësit.

- 13. Lidhur me pasurinë likuiditetet/llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë,** Komisioneri Publik pretendoi se, referuar përmbajtjes së kontratës së blerjes së apartamentit me sipërfaqe 59,2 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Durrës, çmimi 1.400.000 lekë rezulton të jetë ndjeshëm më i ulët, jo vetëm se çmimet e referencës së zonës ku ndodhet pasuria, por edhe nën koston e ndërtimit. Shitja e mëvonshme e këtij apartamenti rezulton në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila ka shërbyer si burim i krijimit të likuiditetit objekt ankimi.

**13.1** Komisioneri Publik, lidhur me burimin e krijimit të apartamentit me sip. 59,2 m<sup>2</sup>, pretendoi se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shtesat dhe kursimet *cash*, të deklaruara në vitet 2010 dhe 2011. Analiza financiare që kryen Komisioneri Publik bazohet në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet *cash* të deklaruara, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

- 14. Lidhur me transaksionet e padeklaruara,** Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj, z. V.P., nuk kanë deklaruar një marrëdhënie huaje në shumën totale prej 25.000 eurosh në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2011, po ashtu nuk është deklaruar edhe kthimi i shumës 25.000 euro në DIPP-në e vitit 2014, hua e cila i rezultoi ILDKPKI-së gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë së subjektit, për efekt të rivlerësimit sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- 15.** Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj, z. V.P., nuk kanë deklaruar një transaksion bankar të datës 24.04.2013, në shumën 1.755.000 lekë, i kryer pranë Bankës Kombëtare të Greqisë, transaksion që i rezultoi ILDKPKI-së gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë së subjektit, për efekt të rivlerësimit sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- 16. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale,** Komisioneri Publik pretendoi se, në zbatim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, ka konstatuar se në dy nga pesë dosjet penale të përzgjedhura, në

dy çështje të ndjekura nga subjekti (dosjet nr. 4 dhe 5), që kanë pasur për objekt të njëjtën veprë penale, atë të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, janë ndjekur standarde të ndryshme hetimi dhe procedimi. Në rastin e dosjes nr. 4, për të pandehurin, shtetasin G.K., është proceduar në kushtet e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa në rastin e dosjes nr. 5, i pandehuri V.S. për të njëjtën veprë penale është proceduar në gjendje të lirë, pa u kërkuar masë sigurimi nga ana e prokurorisë.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

17. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji” ose “trupi gjykues i Kolegjit”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *ii. Legjitimitimi i ankuesit*

18. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### *iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

19. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 103, datë 05.02.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. Donika Prela, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

*B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.*

20. Komisioneri Publik në parashtrimet e depozituara në Kolegj që mbajnë datën 17.07.2020, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që shkaqet parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, për dy denoncime të ardhura në Kolegj pas dorëzimit të ankimit, saktësisht nga një agjenci mediatike dhe nga shtetasi M.K., Komisioneri Publik vlerësoi se denoncimet e paraqitura përmbajnë elementet e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar se këto denoncime mund t'i shërbejnë vlerësimit tërësor, në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

20.1 Lidhur me këto denoncime, Kolegji ka konkluduar se çështjet që trajtohen në to janë të tilla që nuk nevojitet një hetim i mëtejshëm në lidhje me përmbajtjen e tyre. Nga rrethanat dhe kërkimet që janë parashtruar nga denoncuesit në Kolegj, vlerësohet se, bazuar në nenin 53, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, informacionet e përshkruara nuk janë shoqëruar me provat përkatëse, rrethanat dhe faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, ndaj, për këtë arsye, Kolegji çmoi se praktika e dyshuar nuk përmban shkaqe të mjaftueshme për hetimin e mëtejshëm të denoncimeve.

21. Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.07.2020, paraqiti dy kërkesa për përjashtimin e dy anëtareve të trupit gjykues nga gjykimi i çështjes së saj, kërkesa të ngritura mbi pretendimin e ekzistencës së konfliktit të mundshëm të interesit. Këto kërkesa të subjektit të rivlerësimit janë gjykuar nga dy trupa të tjera të Kolegjit, të cilat kanë vendosur mospranimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtareve të trupit gjykues, vendime të cilat i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit.
22. Në seancën e datës 17.07.2020, subjekti i rivlerësimit, përveç parashtrimeve të tij, të depozituara në Kolegj, dorëzoi kërkesë për riçeljen e hetimit gjyqësor, si dhe marrjen në shqyrtim në seancë gjyqësore të provave të renditura si më poshtë.

22.1 Shkresa e datës 21.06.2019, e Kompanisë “{\*\*\*}” ShPK, drejtuar V.P. për pagesën e detyrimeve tatimore.

22.2 Kërkesa nr. {\*\*\*} prot., datë 07.05.2019, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore për pagesën e tatimeve.

22.3 Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe tatimpaguesit shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

22.4 Praktika e Bankës Kombëtare Tregtare mbi likuidimin e tatimit mbi pagën, datë 14.05.2019.

22.5 Praktika Bankës Kombëtare Tregtare e likuidimit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Shoqërore për subjektin V.P., datë 14.05.2019.

22.6 Vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2019, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

22.7 Akti i ekspertimit kontabël, datë 17.12.2018, administruar në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

22.8 Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

22.9 Vërtetimi i datës 25.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkë me vendimin përkatës.

22.10 Ankim kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2019, depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më datë 02.04.2019.

22.11 Vërtetim se çështja është në pritje për gjykim, datë 16.06.2020, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

22.12 Kërkesë e V.P., datë 10.07.2020, drejtuar Qendrës Shëndetësore nr. {\*\*\*} Tiranë, si dhe përgjigja e datës 10.07.2020.

22.13 Printime të dhënash bankare të Intesa Sanpaolo Bank, datë 07.07.2020.

22.14 Shkresë me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.07.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

22.15 Shkresë me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.07.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

22.16 Urdhër i Përbashkët i ish-Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe urdhri nr. {\*\*\*}, datë 28.01.2004, për caktimin e subjektit të rivlerësimit si drejtuese e strukturës.

22.17 Kërkesa e datës 11.06.2019, drejtuar shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe kthim përgjigjeje nga kjo shoqëri, datë 21.06.2019, shoqëruar dhe me kopje të bilanceve të kompanisë.

22.18 Kërkesë e datës 21.05.2019, e V.P., për kopje dokumentacioni, drejtuar ZVRPP Durrës, si dhe praktika përkatëse e vënë në dispozicion nga kjo zyrë, me përgjigjen nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2019.

22.19 Deklarata noteriale e A.M., si dhe kontratë porosie apartamenti, librezë pune, librezë energjie dhe ujësjellësi për apartamentin e kësaj shtetaseje.

22.20 Dokumentacion dhe komunikime me *e-mail* të z. V.P., për qëllim të objektit “Godinë banimi dhe shërbimi” në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës.

22.21 Fletë printim nga Geoportal, datë 05.07.2020, e vendndodhjes së pallatit të ndërtuar në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës.

22.22 Vërtetim i datës 28.05.2019, për të ardhurat e siguruar nga shtetasi A.P. në Itali.

22.23 Vërtetim i datës 28.05.2019, për të ardhurat e siguruar nga bashkëshortja e A.P.

22.24 Certifikata të gjendjes familjare, si dhe personale të familjes së A.P.

22.25 Deklarata noteriale e datës 22.09.2011, e noterizuar nga noteri Gj.K., më datë 31.10.2013.

22.26 Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2011.

22.27 Prokura e posaçme nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 15.07.2011.

22.28 Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 09.03.2020, e Bankës Alpha, me objekt kthim përgjigjeje, drejtuar A.P.

22.29 Librezë kursimesh nr. {\*\*\*}, në emër të shtetasit Gj.P.

22.30 Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2019, e Bankës Raiffeisen, drejtuar shtetasit Gj.P., në lidhje me gjendjen e depozitës.

22.31 Gjendje e llogarisë bankare të shtetasit Gj.P., datë 19.06.2020, e Bankës Kombëtare Tregtare, Durrës.

22.32 Të dhënat e Bankës Raiffeisen, datë 23.06.2020, për shtetasen Gj.P., në lidhje me gjendjen e saj bankare më datë 08.09.2005.



22.33 Vërtetim me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.06.2020, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, për shtetasen Gj.P.

22.34 Kërkesë për verifikim të dhënash për lëshim dokumentacioni shtetasit Gj.P., drejtuar Degës Vendore të Punonjësve, {\*\*\*}, Greqi dhe vërtetim i datës 05.03.2020.

22.35 Përgjigje e datës 08.07.2020, e avokatit N.V., drejtuar shtetasit Gj.P., për situatën e tij të pagesave tatimore në Greqi.

22.36 Certifikata e Sigurisë së Personelit, Kategoria C, Tepër sekret, lëshuar më datë 31.08.2018, me afat vlefshmërie deri më datë 30.08.2023.

22.37 Procedimi penal nr. {\*\*\*}, i Prokurorisë Durrës.

22.38 Procedimi penal nr. {\*\*\*}, i Prokurorisë Durrës.

22.39 Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.07.2020, e Prokurorisë Durrës, bashkë me të dhëna të regjistrimit elektronik për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

22.40 Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2020, e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar, në lidhje me denoncimin e shtetasit M.K.

- 23 Kolegji riçeli hetimin gjyqësor për të hetuar faktet e pretenduara në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të shpjegohet në lidhje me to. Lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike në Kolegji, të listuara më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale, Kolegji vendosi të lejojë marrjen dhe nënshkrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik. Pasi u morën provat e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit, në formën e kërkuar nga ligji, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik*

### **Kontrolli i pasurisë**

24. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 95,6 m<sup>2</sup>, me numër pasurie {\*\*\*}, fituar me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.10.2012, lidhur ndërmjet shoqërive të ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK; “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. V.P. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në cilësinë e blerësit, me adresë në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (*vetting* dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues. Referuar deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratës *vetting*, rezultateve të hetimit administrativ, akteve të administruara dhe përfundimeve

të arritura nga Komisioni, Komisioneri Publik, në rastin konkret, konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, që në kuptim të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, që do ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë e, për pasojë, të sillte konfirmimin në detyrë. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen e Komisionit, Komisioneri Publik pretendoi se në analizën financiare, në zërin e të ardhurave, duhen konsideruar vetëm ato të ardhura për të cilat provohet (i) burimi i ligjshëm i krijimit, (ii) deklarimi i saktë dhe (iii) pagesa e detyrimeve tatimore.

**24.1** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: apartament banimi me sipërfaqe 95,6 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, regjistruar në ZVRPP me numër pasurie {\*\*\*}, me numër hipoteke {\*\*\*}, datë 07.11.2012, në emër të bashkëshortit V.P. Me vlerë 32.000 euro, me pjesë takuese 50% me 50%. Burimi i krijimit: (i) të ardhurat e përbashkëta të krijuara nga puna si prokurore dhe e bashkëshortit V.P. gjatë viteve 2006 (kursime të deklaruara 1.000.000 lekë), (ii) të ardhura të përbashkëta nga puna gjatë vitit 2007, si dhe (iii) hua e marrë nga z. Gj.P., djali i xhaxhait të bashkëshortit, në shumën 15.000 euro, me kontratë verbale. Huaja në shumën 15.000 euro është likuiduar në dy këste, 7.500 euro në vitin 2008 dhe 7.500 euro në vitin 2009, nga të ardhurat e krijuara nga puna si prokurore dhe e bashkëshortit V.P. për vitet 2008-2009.

Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje apartament banimi 2+1. Kontratë porosie, datë 03.05.2007, në emër të V.P., e pahipotekuar, vlera 32.100 euro. Hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 15.000 euro, kontratë verbale me afat 3-vjeçar, marrë nga kushëriri Gj.P.

**24.2** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumente në Komision për të provuar mundësinë e pagesës së kësaj pasurie, ndër të cilat përfshihen listëpagesat e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK (shoqëria për të cilën ka punuar bashkëshorti i subjektit) për vitet 2006 – 2008, nga ku rezulton se pagesat janë bërë me pagë dyjavore neto, dhe se shoqëria ka paguar sigurime shoqërore dhe tatime vetëm për një pjesë të pagës mujore, duke e tatuar pjesërisht atë. Paga neto e përfituar nga bashkëshorti i subjektit në vitet 2006, 2007 dhe 2008 është sipas vlerave të deklaruara edhe në deklaratat periodike (50.000 lekë në muaj) të këtyre viteve, si dhe në deklaratën *vetting*. Në kontratën e lidhur midis z. P. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK është parashikuar paga neto në masën 50.000 lekë në muaj, ndërsa pagimi i sigurimeve shoqërore dhe i tatimit mbi të ardhurat rezultoi se është paguar pjesërisht, vetëm për pjesën e pagës së derdhur në bankë.

**24.3** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, për periudhën 2006-2008, rezulton që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar kontratë pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Si rrjedhojë, të ardhurat e deklaruara në DIPP-të e viteve 2006, 2007, 2008 janë 600.000 lekë në vit, nga të cilat rezultoi se paga e vitit 2006 është paguar *cash* pranë arkës së shoqërisë, paga e vitit 2007 është paguar 248.400 lekë nëpërmjet bankës dhe 351.600 lekë *cash*, po kështu edhe paga e vitit 2008 është paguar 248.400 lekë nëpërmjet bankës dhe 351.600 lekë *cash*. Rezulton se edhe tatimi i

paguar për këto paga është i pjesshëm, vetëm për pjesën e deklaruar në institucionet shtetërore, ndërsa pjesa e pagës *cash* rezultoi e patatuar. Për periudhën 2010-2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar kontratë pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, megjithatë të ardhurat nga paga për këto dy vite janë paguar *cash*, dhe nuk rezulton të jetë kryer pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore e, si rrjedhojë, nuk është paguar as tatimi mbi të ardhurat, periudhë për të cilën nuk rezultoi të ketë as listëpagesa të pjesshme si në periudhën kohore të punësimit 2006-2008.

**24.4** Pasi rezultoi se për një pjesë të të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk janë paguar detyrimet tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, Komisioni për këtë individ i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila i ka kthyer përgjigje<sup>1</sup> se nuk mund të japë informacion nëse ky person figuron i regjistruar në listëpagesat e ndonjë subjekti privat para datës 01.01.2012. Po ashtu, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me përgjigjen e kthyer, sqaron se nuk ka të dhëna për këtë shtetas dhe se të dhënat nga sistemi informatik i disponon nga viti 2012 e në vazhdim<sup>2</sup>. Është pyetur subjekti i rivlerësimit rreth këtij fakti, i cili ka shpjeguar se disponon dokumente se sa ka qenë pagesa e bashkëshortit ndër vite, dokumente të cilat i ka paraqitur në Komision, si: kontratë individuale pune, datë 20.12.2005, me afat 3-vjeçar, dhe pagë neto 50.000 lekë në muaj; kontratë pune, datë 25.08.2010, e lidhur midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit me detyrë drejtues teknik ing. Kjo kontratë është lidhur me afat nga 01.09.2010 - 31.12.2011, me pagë neto 100.000 lekë në muaj, pagesë e cila është kryer nga shoqëria e ndërtimit; vërtetim i datës 27.12.2016, i lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, i cili pasqyron pagesat e bëra ndaj shtetasit V.P. për periudhën me kontratë pune, por edhe për periudhën pa kontratë pune; deklaratë noteriale e shtetasit F.B., me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., e datës 18.09.2018, me cilësinë e ortakut të vetëm dhe administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën ka pasqyruar pagesat neto që i ka bërë shtetasit V.P. gjatë gjithë marrëdhënies së punësimit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK (me dhe pa kontratë pune të formalizuar).

**24.5** Gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në muajin korrik 2018, bashkëshorti i saj ka ardhur në dijeni të faktit se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur një konflikt gjyqësor me një punonjës të saj, për shkak të mospagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2006 - 2007. Nisur nga ky fakt, më datë 30.07.2018, bashkëshorti i subjektit ka paditur shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për ta detyruar të paguajë në llogarinë e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, diferencën e papaguar të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë, të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale të papaguara për periudhën janar 2006 - dhjetor 2009, duke iu referuar pagës mujore neto që parashikon kontrata e punës e datës 20.12.2005, pjesë e objektit të padisë ishte edhe periudha shtator 2010 - dhjetor 2011. Sipas

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018, e Drejtorisë Vendore të Tatim-Taksave.

<sup>2</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2018, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

subjektit, moskryerja e këtyre pagesave nga ana e shoqërisë, ka cenuar të drejtat pasurore të bashkëshortit, që burojnë nga ligji nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar.

**24.6** Kolegji vëren se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, më datë 05.04.2019, në përfundim të gjykimit të çështjes sipas objektit të mësipërm, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2019 (vendim ky i përcjellë në Institucionin e Komisionerit Publik nga një denoncues, pa ekstremite formale vula, nënshkrim etj.), ka pushuar çështjen me arsyetimin se “[...] duke munguar mosmarrëveshja, interesi i ligjshëm, duke qenë se ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, si dhe meqenëse paditësi nuk arrin të provojë faktin cenues së të drejtës së tij, padia është e papranueshme [...]. Në këto kushte, gjykata, në bazë të nenit 299/c të K.Pr.Civile, duhet të vendosë pushimin e gjykimit të padisë së paditësit V.P., si padi pa objekt”. Ky fakt u provua edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, pasi subjekti i rivlerësimit paraqiti ankimin ndaj këtij vendimi, depozituar më datë 02.04.2019, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nga bashkëshorti i saj.

**24.7** Kolegji vëren se Komisioni, pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me marrëdhënien e punës së bashkëshortit të saj, ka konkluduar se: *[...] shtetasi V.P. vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se marrëdhënia e tij e punësimit është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme. Mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave në shumën totale prej 2.584.910 lekësh ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti [...]. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin se nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit dhe se bashkëshorti i saj nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësin për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, porse ai ka qenë i dëmtuar nga ky proces. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mospagesat e detyrimeve përkatëse dhe, si rezultat, të ardhurat nga paga të marra ndër vite, do të merren në konsideratë në përlllogaritjen e mjeteve financiare të disponueshme në familjen e tij.*

**24.8** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë me një pagesë të caktuar, një pjesë e së cilës i është paguar nëpërmjet bankës dhe pjesa tjetër sipas listëpagesave, pjesë e dokumentacionit të dërguar në Komision nga {\*\*\*} ShPK, e tërhequr vetë në *cash* pranë arkës së shoqërisë (deklaruar edhe në DIPP-të në vite). Diferencat në vlerën mes pagës mujore të kaluar nga shoqëria përmes llogarisë bankare dhe pjesës së tërhequr *cash* janë rrethana të mjaftueshme për të sjellë në dijeninë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit se një pjesë e pagës i nënshtrohet pagesës së taksave dhe pjesa tjetër jo. Fakti që subjekti, edhe gjatë procesit të rivlerësimit, ka nënvizuar mospasjen dijeni të saj dhe të bashkëshortit për këtë shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore në marrëdhëniet e punës, është rrethanë që rëndon pozitën e saj për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi e bën të pabesueshëm shpjegimin e saj në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit në atë kohë ushtronte funksionin e prokurores dhe ishte përgjegjëse për ndjekjen e veprave penale në lidhje me taksat dhe tatimet, të parashikuara në Seksionin VI të Kreut III të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Për pasojë, çmohet i papranueshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti i

saj nuk kishte dijeni për mospagimin e taksave për pagat e marra në shoqërinë {\*\*\*} ShPK, të ardhura këto të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive. Në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, për këto të ardhura të deklaruara<sup>3</sup>, duheshin paguar detyrimet tatimore, në kuptim të kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**24.9** Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, në seancën publike të datës 17.07.2020, në Kolegj, shpjegoi se në shkresën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të datës 19.07.2018, provohet se janë derdhur kontributet (tatimet) për periudhën janar 2006 – shkurt 2007 në vlerën 15.000 lekë në muaj dhe për periudhën mars 2007 – prill 2007 janë në vlerën 48.700 lekë në muaj. Në muajt maj, qershor, korrik 2007 është 40.000 lekë në muaj, në periudhën gusht 2007 deri në dhjetor 2008 është 25.000 lekë në muaj, ndërsa për periudhën janar 2009 në shumën 3.409 lekë në muaj. Subjekti pretendoi që, pavarësisht se ka pasur një kontratë pune me të njëjtat kushte, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK në disa raste ka paguar detyrimet sipas pagës së kontraktuar, në disa raste tjera për një pagë më të ulët, por gjithmonë pa cenuar pagën neto të përcaktuar në kontratë.

**24.10** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjendet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik, i cili në seancën publike, datë 27.07.2020, në funksion të shkaqeve të ankimit, parashtrori se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020 në Kolegj, përfaqësojnë veprime të kryera për efekt të procesit të rivlerësimit nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas depozitimit të ankimit nga ana e Komisionerit Publik dhe, si të tilla, duhet të merren me rezervë në këtë proces. Për sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit mbi ligjshmërinë e të ardhurave, vlerësohet se ato duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Lidhur me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për ardhjen në dijeni vetëm përmes vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 19.07.2018, të Drejtorisë së Arshivës të Sigurimeve Shoqërore, të faktit të mospagimit të detyrimeve tatimore nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK për periudhat 2006 – 2008, si dhe 01.09.2010 - 31.12.2011, në vlerësimin e Kolegjit, nuk janë të besueshme, pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të i kishin mundësitë dhe arsyet për të pasur dijeni për këto detyrime të papaguara. Duhet të merret në konsideratë këtu edhe fakti se në aktet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se në kolonat përkatëse të listëpagesave të viteve 2003-2008 për punonjësit e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nënshkruar nga vetë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, specifikohet se paga është arkëtuar pjesërisht në llogari bankare (gjysma e vlerës së deklaruar si pagë neto, ku janë zbritur detyrimet tatimore për këtë vlerë) dhe pjesërisht *cash* në arkën e shoqërisë (gjysma e mbetur e vlerës së deklaruar si pagë neto e patatuar). Për periudhën nga 01.01.2009 deri 01.09.2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar marrëdhënien e punës me shoqërinë e ndërtimit {\*\*\*} ShPK, pasi nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se për këtë periudhë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}”, të ardhura të cilat janë përlllogaritur në analizën financiare të këtyre viteve.

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. 6/2019(JR), datë 28.02.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 21.29.

**24.11** Kolegji vëren se gjendet i drejtë gjithashtu pretendimi i Komisionerit Publik, se duhet të konsiderohen burime të ligjshme vetëm ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, përkundër shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, se [...] *i takon punëdhënësit të zbresë nga paga dhe të paguajë në organet përgjegjëse tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe nuk është përgjegjësi e punëmarrësit mospërmbushja e këtij detyrimi [...]*, pasi ky shpjegim nuk ndikon në një interpretim të ndryshëm të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga sa është interpretuar tashmë gjyqësisht dhe ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe detyrimin kushtetues të përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore.

**24.12** Në këtë kuadër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshe nga pagesa e detyrimeve tatimore në marrëdhënie të tjera juridike, si qiraja, ndër të tjera, ku detyrimi kryesisht mbetet me përfituesin e të ardhurave [qiradhënësin], në marrëdhëniet e punës, përfitim nga evazoni fiskal kanë të dyja palët. Punëdhënësi, si edhe në rastin konkret, deklaron dhe derdh detyrime bazike për punëmarrësin, ndërsa punëmarrësi përfiton të ardhura *cash*, të padeklaruar për qëllime tatimore. Pikërisht në konsideratë të rrethanave faktike konkrete, në të cilat bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka marrë vetëm një pjesë të pagës nëpërmjet bankës dhe ka paguar një detyrim tatimor që i korrespondon pagesës së kryer në bankë, trupi gjykues konstaton se qëndron e provuar dijenia e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj për faktin që detyrimet tatimore për llogari të pagës së z. P. paguheshin në më pak se shuma e përcaktuar në kontratë. Për më tepër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se marrëdhënia mes z. P. dhe z. B. ishte marrëdhënie jotipike punëdhënës - punëmarrës. Siç është përshkruar kjo marrëdhënie nga subjekti i rivlerësimit dhe është dëshmuar nga shkresat e sjella prej saj, z. P. ruajti marrëdhënie bashkëpunimi apo profesionale/biznesi edhe pasi ishte i punësuar nga Bashkia Tiranë apo kreu edhe veprime për llogari të shoqërisë {\*\*\*} ShPK në sportelin e ZVRPP Durrës, një kohë të gjatë pasi kishte pushuar marrëdhënia profesionale. Në dritë të sa më sipër, e konkretisht, faktit që z. P. ka pranuar përfitimin e një pjese të konsiderueshme të pagës – sipas kontratës – në *cash* dhe faktit që marrëdhënia mes tij dhe punëmarrësit, në të cilën z. P., drejtues punimesh dhe i punësuar për periudha të konsiderueshme kohore nga shoqëria {\*\*\*} ShPK, nuk rezulton të ketë qenë në pozita të një punëmarrësi vulnerabël, të mbajtur në errësirë të mënyrës se si shoqëria operonte, përfshirë edhe pagesat mujore të pagës, trupi gjykues i Kolegjit e konsideron shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit jobindës, kontradiktor dhe të pasinqertë.

**24.13** Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, si dhe ato të sigurimeve shoqërore, për të cilat është cenuar e drejta e bashkëshortit të saj, nga provat e sjella në seancën publike të datës 17.07.2020, rezultoi se, pas ankimit të vendimit, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka paguar rreth 1.5 milionë lekë sigurime shoqërore/shëndetësore dhe tatime për V.P. Në cilësinë e provës<sup>4</sup>, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në të njëjtën seancë dokumentacionin për pagesat e kryera të sigurimeve shoqërore e

---

<sup>4</sup>Provat e listuara në pikën 22.1 deri në pikën 22.6 të këtij vendimi.

shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat. Në provat që subjekti i rivlerësimit paraqiti në seancën e datës 17.07.2020, rezulton shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2019, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, në të cilën citohet se: *Tatimpaguesi person juridik {\*\*\*} ShPK, me NIPT {\*\*\*}, me administrator z. F.B., me objekt veprimtarie “Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jorezidenciale”, rezulton se deri më datë 18.10.2019 nuk ka detyrime tatimore në tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, tatimin e mbajtur në burim, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit pretendoi të provojë se të gjitha detyrimet tatimore të papaguara për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, janë shlyer nga {\*\*\*} ShPK në vitin 2019. Për këtë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumentacionin bankar të likuidimit të këtyre detyrimeve, cituar në pikat 22.4 dhe 22.5 të këtij vendimi. Në konkluzion, sa i përket përpjekjes së subjektit të rivlerësimit për të arritur te kryerja e pagesave të detyrimeve tatimore në funksion të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret pas depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik, konsiderohet nga trupi gjykues i Kolegjit e paefektshme në funksion të këtij procesi.*

**24.14** Nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se bashkëshorti i saj erdhi në dijeni të faktit që nuk i janë paguar taksat në vitin 2018, në një kohë që në përmbajtjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, rezulton se konflikti gjyqësor mes paditësit E.B. dhe të paditurit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka lindur që në vitin 2014. Gjithashtu rezultoi e provuar se shoqëria ndërtuese ka paguar 1,5 milion lekë për likuidimin e taksave dhe tatimeve të punëmarrësit V.P., pagesa këto të kryera pa vendim gjyqësor. Nga ana tjetër, nga dokumentacioni i administruar në Komision, në listë-pagesat e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, mospagimi i taksave dhe detyrimeve tatimore nuk ishte një problem vetëm për V.P., por një dukuri për shumë punonjës të kësaj shoqërie. Në këto kushte, Kolegji e gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik në seancën e datës 27.07.2020 se veprimet e kryera dhe shkresat e sjella nga subjekti i rivlerësimit për sa i përket përpjekjes së {\*\*\*} ShPK për të kryer pagesat vullnetarisht, duhet të merren me rezerva.

**24.15** Nga faktet e rezultuara në Kolegji, lidhur me sa më sipër, krijohet bindja se mes përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka pasur dhe ka një marrëdhënie që e tejkalon atë mes punëmarrësit dhe punëdhënësit. Nga provat e administruara në Komision, por edhe gjatë gjykimit në Kolegji, rezultoi se i gjithë informacioni për marrëdhënien e punës për V.P. ka ardhur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Fakt tjetër është që marrëdhëniet mes përfaqësuesit të kësaj shoqërie dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë filluar që në vitin 2003 dhe kanë vazhduar edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës në vitin 2011. Në vlerësimin e Kolegjit, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mjafton vetëm deklarimi dhe kontratat e pjesshme të punës, që të vërtetohet se të ardhurat e përfituara nga V.P. janë me burim të ligjshëm dhe që të konsiderohen të ligjshme.

**24.16** Kolegji vlerësoi se nga analiza e mësipërme rezultoi se konkluzionet<sup>5</sup> që gjenden në arsyetimin e vendimit të Komisionit, janë të gabuara, pasi bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë në dijeni që punëdhënësi i tij po kryente veprime në kundërshtim me ligjin për shmangien e detyrimeve tatimore ndaj institucioneve shtetërore dhe është dakordësuar me këtë praktikë të tij, duke e miratuar dhe firmosur pagën e pjesshme në borderotë e shoqërisë, veprim i cili ka sjellë shmangien e tatimeve të gjysmës së pagës, për shkak të interesit të ndërsjellë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, me provat e sjella bashkëngjitur parashtrimeve në Kolegji, nuk provoi bindshëm se bashkëshorti i saj ka qenë në kushtet e mirëbesimit për pagimin e taksave nga ana e shoqërisë punëdhënëse dhe se nuk ka qenë në dijeni që punëdhënësi i tij po kryente veprime në kundërshtim me ligjin për shmangien e detyrimeve tatimore. Përkundrazi, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, nga provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krijua bindja se bashkëshorti i saj ka qenë në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pasi ai vetë pranonte dhe firmoste që vetëm një pjesë e pagës t'i nënshtrohej tatimit. Nuk rezultoi asnjë përpjekje në kohë reale e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, drejtuar punëdhënësit, për pagimin e detyrimeve tatimore dhe pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ndaj në këto kushte nuk është bindës as pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se detyrimin<sup>6</sup> për deklarim pranë organeve tatimore e ka pasur punëdhënësi, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

**24.17** Kolegji arriti në konkluzionin se përderisa bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë në dijeni dhe është dakordësuar me faktin që punëdhënësi i tij shmangte detyrimet tatimore dhe ato për sigurime shoqërore, ai dhe, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit duhet të përballen edhe me pasojën e kësaj sjelljeje karshi ligjit dhe subjekti i rivlerësimit duhet të mos mbrohet me pretendimin se ishte punëdhënësi që kishte detyrimin për të kryer këto pagesa, por të bashkëvuajë konsekuencat ligjore të kësaj sjelljeje, të cilat, për punëdhënësin përkthehen në detyrimin për pagim të detyrimeve të prapambetura dhe për personin e lidhur në konsiderimin si të ardhura të paligjshme të këtyre vlerave pasurore për efekt të procesit të rivlerësimit. Dhe pasojat ligjore janë se këto të ardhura, të cilat janë deklaruar si burim për krijimin e pasurisë në vitin 2007, për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar si të ardhura të krijuara nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit<sup>7</sup>. Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik gjendet i bazuar.

- 25.** Një tjetër shkak të cilin Komisioneri Publik ka ngritur në ankim, është mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet e deklaruara në vlerën 1.000.000 lekë në vitin

<sup>5</sup> Paragrafët 40 dhe 41 të vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 7/2019(JR), datë 05.04.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 22.

<sup>7</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 7/2019(JR), datë 05.04.2019, paragrafi 23; nr. 8/2019(JR), datë 16.04.2019, paragrafi 63; nr. 19/2019(JR), datë 26.07.2019, konkluzione, faqe 51; nr. 5/2020(JR), datë 13.03.2020, paragrafi 41.9.



2006, pasi nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për një diferencë negative prej 285.131 lekësh, si dhe mundësia e subjektit të rivlerësimit për të kryer pagesën e kësteve të apartamentit nga të ardhurat e vitit 2007, ku Komisioneri pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme pagesën e shumës prej 1.100.000 lekësh, të deklaruara si të paguara në vitin 2007, me burim të ardhurat nga paga, për një diferencë negative prej 450.240 lekësh.

**25.1** Lidhur me analizën e shpenzimeve të jetesës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Komision një analizë financiare për t’iu përgjigjur rezultateve të hetimit, në të cilën ka vendosur si shpenzime jetese pikërisht vlerën 540.000 lekë në vit dhe në rezultat final, duke i zbritur shpenzimet nga të ardhurat, në analizën e tij ka rezultuar një diferencë negative prej 123.186 lekësh për vitin 2006. Në parashtrimet e seancës gjyqësore të datës 17.07.2020, subjekti i rivlerësimit, përveç kursimit 1.000.000 lekë të deklaruar në fund të vitit 2006, pretendoi se ka pasur kursime të tjera të cilat i kishte tërhequr nga llogaria e Bankës Intesa SanPaolo dhe i kishte mbajtur në banesë, në vlerën 248.055 lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka tërhequr këtë shumë gjatë vitit 2006. Të ardhurat nga kjo llogari bankare e tij janë konsideruar si gjendje në fund të vitit 2005 dhe janë konsideruar në kursimet e subjektit të rivlerësimit. Në seancën gjyqësore të datës 17.07.2020, subjekti i rivlerësimit pretendoi se këtë shumë e ka pasur *cash* në banesë në fund të vitit 2006. Kjo gjendje e llogarisë bankare nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet vjetore dhe *vetting*, pavarësisht detyrimit që buron nga neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Në këto kushte, Kolegji, meqenëse kjo gjendje likuiditeti u konfirmua edhe nga Banka Intesa SanPaolo, çmoi se duhet t’i përlllogaritjet subjektit të rivlerësimit në analizën financiare. Pas dorëzimit të provave nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020 dhe pretendimit të tij në lidhje me shtimin e kursimit në fund të vitit 2006, në vlerën 248.055 lekë, Komisioneri Publik ka kryer edhe një herë përlllogaritjet financiare për vitin 2006, nga ku, me përfshirjen e kësaj shume, u thellua diferenca negative e këtij viti, në vlerën 533.186 lekë.

**25.2** Lidhur me ndryshimet e të ardhurave nga paga, subjekti i rivlerësimit pretendoi që të përdoret paga e plotë e bashkëshortit të saj dhe jo paga e konfirmuar nga institucionet shtetërore. Nga sa u analizua në paragrafët më sipër këtij vendimi lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave, Kolegji vlerësoi që bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit t’i përlllogaritjet vetëm pjesa e pagës që i është nënshtruar detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si e ardhur e cila i është provuar me dokumentacion, shpjeguar bindshëm burimi, është deklaruar, dhe për të cilën është paguar detyrimi tatimor.

**25.3** Kolegji vlerësoi se lidhur me shkakun e ankimit për mundësinë e shlyerjes së shumës prej 1.100.000 lekësh për blerjen e apartamentit në vitin 2007, rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit, me burim të ardhurat nga pagat, në këtë vit është kryer pagesa e apartamentit e ndarë në dy këste. Kësti i parë është shlyer në datën 03.05.2007 në shumën 12.100 euro dhe kësti i dytë në datën

31.12.2007 në shumën 5000 euro. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të kursente nga pagat vlerën e pretenduar të paguar për këstin e parë dhe këstin e dytë të apartamentit në vitin 2007 dhe gjithashtu nuk mund të krijonte kursime në vlerën e pretenduar në fund të vitit 2006. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për përballimin e krijimit të kësaj pasurie.

**25.4** Kolegji arsyetoi se, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: [...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative<sup>8</sup> këto dy kritere, që (i) janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Ndryshimi ndërmjet shumës së tërhequr nga llogaria bankare me atë të deklaruar në kontratën individuale të punës dhe të deklaruar në deklaratën periodike përkatëse, janë rrethana që çojnë në konkluzionin se punëmarrësi ka qenë në dijeni që tatóhet vetëm për një pjesë të pagës së deklaruar, duke iu shmangur kështu detyrimeve tatimore, si dhe mospagimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

**25.5** Kolegji kreu analizën financiare për periudhën 2006-2007, nga e cila rezultoi se diferenca negative është të paktën sa ajo e konstatuar nga ankimi i Komisionerit Publik, ndaj trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se sipas kësaj analize rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte shpenzimet e këtyre viteve me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar kështu me pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht.

**25.6** Në përfundim të sa më sipër, konkluzioni<sup>9</sup> i Komisionit në vendimin e arsyetuar është i gabuar dhe joligjor, pasi Kolegji çmoi se të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë vlerësuar në analizën financiare në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vetëm për pjesën e pagës që është paguar tatimi në momentin e krijimit të të ardhurës.

- 26.** Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit, pretendoi se huadhënësi, z. Gj.P., nuk ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumën prej 15.000 eurosh bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik, në mënyrë të përmbledhur, pretendoi se nuk provohet marrëdhënia e huas në kuptim të mundësive që ka pasur z. Gj.P. për dhënien e kësaj huaje, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, gjithashtu nuk provohet me dokumentacion kjo marrëdhënie huaje, përveç deklaratës noteriale të hartuar *a posteriori* për këtë proces.

**26.1** Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2007, ka deklaruar hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi Gj.P. me kontratë verbale, pa interes dhe me afat 3-vjeçar. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësoin nr. 2 të Komisionit se në momentin e huadhënies, bashkëshorti i saj ka lëshuar një deklaratë “dore” për pranimin e huas, e cila është asgjësuar pas likuidimit të kësaj të fundit. Lidhur me burimin e të ardhurave të z. Gj.P. si person tjetër i lidhur,

<sup>8</sup> *Vendimi nr. 6/2019(JR), datë 28.02.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 21.12.*

<sup>9</sup> *Paragrafi 41 i vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.*

për shkak të marrëdhënies së huas së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe detyrimit për efekt të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë dhe për të provuar marrëdhënien e huas, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2016, të nënshkruar nga Gj.P., në përmbajtjen e së cilës deklararon se në periudhën kohore nga viti 1992 deri në fund të vitit 2002 ka punuar si emigrant në Greqi, në vende të ndryshme, për dy vite, ndërsa për tetë vite të tjera në qytetin {\*\*\*}, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Gjatë kohës së qëndrimit në Greqi, ka qenë pjesërisht i siguruar, si dhe deklararon se këto të ardhura i ka sjellë *cash* dhe jo me bankë. Gjithashtu, sa i përket huas së dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nga të ardhurat nga puna gjatë qëndrimit si emigrant në Greqi, nëpërmjet deklaratës me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2016, Gj.P. ka deklaruar se më datë 01.05.2007 i ka dhënë hua pa asnjë lloj interesi shtetasit V.P. shumën 15.000 euro, me afat 3-vjeçar. Kjo hua i është kthyer huadhënësit me dy këste, 7500 euro në dhjetor të vitit 2008 dhe 7500 euro në dhjetor të vitit 2009 dhe deklararon se mes tyre nuk ka asnjë lloj detyrimi për likuidim.

**26.2** Lidhur me shumën e dhënë hua në vlerën 15.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nga huadhënësi, sipas kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Nga dokumentacioni i administruar në dosje në lidhje me këtë hua, nuk është paraqitur para Komisionit asnjë dokument justifikues i kësaj marrëdhënieje juridike<sup>10</sup> që të vërtetojë dhënien dhe kthimin e shumës. Huadhënësi Gj.P. dhe subjekti i rivlerësimit kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pjesë kjo e çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 95,6 m<sup>2</sup> në Tiranë, por subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të vërtetuar marrjen dhe kthimin e saj, përveç deklaratës noteriale të cituar në paragrafin më sipër. Lidhur me deklaratën noteriale të huadhënësit, duhen pasur në konsideratë qëndrimet<sup>11</sup> që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, sipas të cilave megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë dhe për shkak të procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

**26.3** Trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me të ardhurat me burim emigracionin, ka parasysht qëndrimin<sup>12</sup> e Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës,

<sup>10</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 7/2018(JR), datë 25.09.2018, paragrafi 44; nr. 10/2018(JR), datë 19.11.2018, paragrafi 37.

<sup>11</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018(JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

<sup>12</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 12/2018 (JR), datë 17.12.2018, paragrafët 22 dhe 23; nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019, paragrafët 20.11 dhe 20.12.

lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse. Për rrjedhojë, këto të ardhura me burim emigracionin nuk e bindën Kolegjin se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.

**26.4** Kolegji vëren se me parashtrimet e datës 17.07.2020, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar provat e listuara në pikat 22.29 deri 22.35 të këtij vendimi, sipas të cilave ka parashtruar se mbi bazën e dokumentacionit që është vënë në dispozicion nga vetë personi tjetër i lidhur, shtetasi Gj.P., provon në mënyrë të pakundërshtueshme se ky shtetas ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumë 15.000 euro. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka arritur të vërtetojë se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt gjykimi, sipas këtij shkak ankimi, ka humbur dhe se nuk mund të bëhet përsëri dhe nuk mund të merret në rrugë tjetër, pasi ky informacion gjendet në një shtet tjetër, në Greqi. Për arsyet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndodhet para pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 për të siguruar dokumentacion tjetër ligjor provues, përveç atij të administruar në gjykim në Komision dhe provave të reja të sjella për këtë shkak ankimi. Subjekti i rivlerësimit kërkon gjithashtu t'i bëhet analiza financiare Gj.P., duke marrë autorizimet përkatëse.

**26.5** Komisioneri Publik, në seancën e datës 27.07.2020, parashtrroi se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020 në Kolegj, nuk sjellin ndonjë risi dhe nuk pasqyrojnë ndonjë rrethanë juridike të ndryshme nga sa është dokumentuar dhe nga sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, mbi mundësinë financiare të shtetasit Gj.P. për të dhënë nga burime të ligjshme huan në shumë 15.000 euro. Në përfundim të analizës së provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk pasqyrojnë ndonjë situatë të ndryshme nga sa është dokumentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, dhe mbetet e pakonfirmuar mundësia financiare e shtetasit Gj.P. për të dhënë huan në shumë 15.000 euro, me të ardhura të ligjshme.

**26.6** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se për efekt të provueshmërisë së kriterëve ligjore, në përputhje me nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që, në rastet e deklaramit si burim krijimi të pasurive të tyre të ardhurat nga emigracioni<sup>13</sup>, të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij. Në këtë kuptim të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, pika 21 “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklaramit të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, në përputhje me parashikimin kushtetues të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përmbushen vetëm në saje të administrimit të dokumentacionit që provon ekzistencën e (i) një burimi real të ardhurash dhe (ii) vlerën e të

---

<sup>13</sup> Vendimi nr. 9/2018 (JR), datë 24.10.2018, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafët 83 dhe 84.

ardhurave të krijuara nga personi deklarues, dhe jo të mundësisë objektive për t'u zënë me punë që ekuivalentohet me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së deklaruar. E parë në këndvështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive* – subjekti i rivlerësimit është i ngarkuar me detyrimin për të justifikuar mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për dhënien e kësaj huaje që i ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, dhe përderisa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm, kjo rrethanë bëri që huaja e marrë nga Gj.P. të mos konsiderohet si burim i ligjshëm i krijimit të pasurisë. Pretendimi më sipër i subjektit të rivlerësimit, parë në funksion të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të faktit që huadhënësi Gj.P. ka ruajtur dokumentacion më të hershëm për punën në emigracion për vitet 1998-2001 dhe deklaroi se i ka humbur dokumentacionin për vitet 2002 e më pas, vlerësohet si mosparaqitje e dokumentacioneve justifikuese që vjen për shkaqe të paarsyeshme dhe, për pasojë, shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se dokumentacioni ka humbur, nuk është bindës për Kolegjin.

**26.7** Kolegji vëren se nga analiza financiare e kryer bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, rezultoi se për aq sa kemi dokumentacion për z. Gj.P., provohet se ka punuar në Greqi për 290 ditë dhe të ardhurat që ka siguruar kanë vlerën rreth 1.383.460,24 dhrahmi greke, të cilat të konvertuara në lekë me kursin e secilit vit, sipas publikimit të Bankës të Shqipërisë, vlerësohet se të ardhurat e ligjshme nga emigracioni janë në vlerën 559.435 lekë. Të ardhurat nga shitja e tokës nga Gj.P. janë në vlerën 1.000.000 lekë. Të ardhurat nga puna në Autoritetin Portal Durrës, që nga viti 2004 deri në prill 2007 (analiza është kryer deri në momentin e blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj), janë në vlerën 1.024.972 lekë. Totali i të ardhurave të Gj.P. të provuara me dokumentacion është në vlerën 2.584.227 lekë. Nga analiza e kryer në Kolegji, të gjitha të ardhurat e provuara për Gj.P. nuk mund të shërbejnë për të jetuar e për të kursyer shumë 15.000 euro, e cila është gati sa të gjitha të ardhurat e krijuara sipas dokumentacionit.

**26.8** Nga sa më sipër, duke u bazuar në provat që ka sjellë subjekti i rivlerësimit për mundësinë e huadhënies, rezultoi se Gj.P. nuk mund të kursente me të ardhura të ligjshme vlerën 15.000 euro, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burimi i blerjes së apartamentit me sipërfaqe 95,6 m<sup>2</sup>. *Sa i përket këtij shkak ankimi të ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

27. Në lidhje me mundësinë e kthimit të huas prej 15.000 euro nga subjekti i rivlerësimit kundrejt Gj.P., në dy këste prej 7500 eurosh, njëri kthyer në dhjetor të vitit 2008 dhe kësti tjetër kthyer në dhjetor të vitit 2009, Komisioneri Publik pretendoi në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të likuiduar huan në një diferencë negative prej 405.697 lekësh.

**27.1** Sipas analizës financiare të kryer në Kolegji, rezultoi se Komisioneri Publik në ankimin e tij nuk e ka përllogaritur huan e dhënë nga z. Gj.P. si të ardhur, për shkak se kjo shumë nuk ishte

krijuar nga të ardhura të ligjshme. Pavarësisht këtij fakti, Komisioneri kryen përlllogaritje për shlyerjen e kësaj huaje nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2008 dhe në vitin 2009.

Në këto kushte, nga trupi gjykues i Kolegjit vlerësohet se nuk mund të rëndohet subjekti i rivlerësimit edhe me shpenzime për shlyerjen e një huaje e cila i konsiderohet si e pamundur për t'u përdorur.

*27.2 Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë apartament banimi me sip. 95,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, rezultoi se, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për të justifikuar pasurinë me vlerë 32.000 euro.*

- 28. Lidhur me pasurinë likuiditet/llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë**, Komisioneri Publik pretendoi se, referuar përmbajtjes së kontratës së blerjes së apartamentit me sipërfaqe 59,2 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Durrës, çmimi i blerjes 1.400.000 lekë rezulton të jetë ndjeshëm më i ulët jo vetëm se çmimet e referencës së zonës ku ndodhet pasuria, por edhe nën koston e ndërtimit. Shitja e mëvonshme e këtij apartamenti rezulton në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila ka shërbyer si burim i krijimit të likuiditetit objekt ankimi.

**28.1** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë pranë Bankës BKT, në emër të z. V.P. Burimi i krijimit të kësaj llogarie nga: (i) shitja e apartamentit me sip. 59,2 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.000.000 lekë, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, si dhe (2) kursimet nga paga e të dy bashkëshortëve gjatë viteve, depozituar në bankë më datë 29.02.2016.

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Blerje apartamenti me sipërfaqe 59,2 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, me anë të kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e datës 22.02.2014, në shumën 1.400.000 lekë”. Burimi i krijimit: “Kursime nga të ardhurat e krijuara në vitin 2015, përfshirë dhe ato të deklaruara në vitin 2014 dhe më parë 1.200.000 lekë gjendje *cash*. Sqarojmë se nga kursimet është realizuar blerja e apartamentit”. Subjekti i rivlerësimit në të njëjtën deklaratë ka deklaruar: “shitja e apartamentit të mësipërm me vlerën 4.000.000 lekë”.

*Komisioni lidhur me këtë pasuri ka konkluduar se përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.*

**28.2** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve<sup>14</sup> të Komisionit mbi diferencën e çmimit, ka sqaruar se ky çmim është dhënë në vlerë të tillë, referuar marrëdhënies së punës midis bashkëshortit të saj dhe administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas bisedës që ka pasur me të, do të përfitonte një apartament 1+1, për të cilin V.P. do të paguante zero lekë, pra në kontratën e apartamentit do të përcaktohej në natyrë vlere e punës së kryer nga bashkëshorti i saj; shprehimisht subjekti i rivlerësimit thotë: [...] *Ju bëj me dije se V.P. më ka bërë*

<sup>14</sup> Përgjigjet e pyetësorit datë 31.10.2018 dhe të pyetësorit datë 01.11.2018.

*me dije se [...] firma ka trajtuar me çmim preferencial edhe punonjës të tjerë. Për të vërtetuar këtë fakt, Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.09.2018, në të cilën administratori i kësaj shoqërie shprehet se [...] çmimi i përcaktuar në vlerën 10.000 euro (1,4 milion lekë) nuk është çmim favorizues, por çmim i përcaktuar me marrëveshje verbale për shkak të punësimit të V.P. si inxhinier ndërtimi në objektin ku ndodhet apartamenti. Në të njëjtën shkresë, administratori i shoqërisë sqaron se [...] sipas marrëveshjes që kam pasur me shtetasin V.P., nëse ai do të qëndronte deri në përfundim të ndërtimit të objektit, apartamenti do t’i llogaritej si vlerë e pagesës së punës së kryer krahas pagës neto me 100.000 lekë/muaj. Meqenëse në muajin dhjetor 2011 ai është larguar nga drejtimi i punimeve, është përcaktuar çmimi i shitjes prej 10.000 euro.”*

**28.3** Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, bashkangjitur shkresës së cituar më sipër, ka paraqitur edhe kontratën e punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, e cila mban datën 25.08.2010, ku nuk parashikohen kushtet e mësipërme të pretenduara nga ana e subjektit, kushte të cilat nuk reflektohen as në provat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit. Paga e parashikuar në këtë kontratë është 100.000 lekë neto në muaj dhe nuk parashikon kompensime të punës me ndërtimin që po kryhej.

**28.4** Kolegji vëren se në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerje apartamenti me sipërfaqe 59,2 m<sup>2</sup> dhe vlerë 1.400.000 lekë, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, si dhe shitjen e këtij apartamenti po këtë vit, më datë 11.12.2014, me vlerë 4.000.000 lekë. Kjo shitje e pasurisë brenda vitit, nga e cila subjekti i rivlerësimit ka fituar 2.600.000 lekë, pra diferencën mes çmimit që e ka shitur pasurinë (4.000.000 lekë) dhe çmimit që e ka blerë më parë (1.400.000 lekë), po në të njëjtin vit, shtyu Komisionin për t’iu drejtuar ZVRPP Durrës, për të kërkuar informacion në lidhje me praktikën e shitjes së këtij apartamenti. ZVRPP Durrës i ka kthyer përgjigje<sup>15</sup> Komisionit, duke i bashkëngjitur edhe gjithë dokumentacionin e kësaj praktike, në të cilën rezulton një mandatar-këtimi, ku shuma 412.426 lekë është arkëtuar më datë 18.02.2015 për ZVRPP Durrës nga A.M. (blerësja e apartamentit), me komentin “tatim shitjeje”.

**28.5** Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020, të zhvilluar në Kolegji, ka parashtruar se: [...] *Është përcaktuar me marrëveshje verbale mes palëve si pagesë për punën e kryer deri në momentin e largimit nga puna të bashkëshortit në vitin 2011, krahas pagës neto të përfituar [...]. Ky nuk përbën çmim preferencial, por pagesë për punën e kryer [...]. Po kështu, dhe të ardhurat tona të përfituara nga shitja e apartamentit janë të ardhura të ligjshme, që rrjedhin nga punë e ligjshme e bashkëshortit dhe për të cilat është paguar rregullisht tatimi mbi fitimin e diferencës së çmimit të blerjes me atë të shitjes në momentin e regjistrimit në ZVRPP Durrës [...].* Gjatë kësaj seance, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, paraqiti edhe provat e listuara në pikat 22.19 dhe 22.20 të këtij vendimi.

---

<sup>15</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2018.

**28.6** Komisioneri Publik vlerësoi se me aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020, mbi ligjshmërinë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, nuk provojnë të kundërtën e konkluzionit të arritur, se për blerjen e apartament në Durrës, shitja e të cilit ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë depozitë bankare, subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, blerjen e apartamentit në {\*\*\*}, Durrës.

**28.7** Kolegji vëren se duke iu referuar praktikave<sup>16</sup> të tij për të krahasuar vlerën e blerjes së apartamentit me çmimin e kostos për m<sup>2</sup>, sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), rezulton, sipas Udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2013, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013”, se çmimi i shitjes është 74.000 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa kostoja e ndërtimit, sipas të njëjtit udhëzim, rezulton në vlerën 36.203 lekë/m<sup>2</sup> për qytetin e Durrësit. Sikur të përlogaritim vetëm me vlerën e kostos 59,2 m<sup>2</sup>, që është sipërfaqja e apartamentit, do të kishim një vlerë prej 2.143.220 lekësh. Kjo vlerë rezulton të jetë rreth 700.000 lekë më pak se vlera e çmimit të apartamentit të blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ose 1/3 e çmimit total sipas çmimit të udhëzimit të EKB-së. Që këtë rezulton se kostoja e ndërtimit të apartamentit në këtë periudhë është më e lartë se çmimi që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit, çka e bën të duket joreale dhe jobindëse vlerën e blerjes së tij.

- 29.** Komisioneri Publik, lidhur me burimin e krijimit të apartamentit me sip. 59,2 m<sup>2</sup>, pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shtesat dhe kursimet *cash* të deklaruara në vitet 2010 dhe 2011. Analiza financiare që kryen Komisioneri Publik bazohet në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet *cash* të deklaruara, që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

**29.1** Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime të krijuara nga të ardhura nga pagesa si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pagesa e bashkëshortit si inxhinier ndërtimi [...] 500.000 lekë kursime [...].*

**29.2** Kolegji vëren se në analizën ekonomike të kryer për vitin 2010, janë përfshirë të ardhurat sipas vërtetimeve përkatëse të institucioneve zyrtare të administruara në dosje, të cilat në total për këtë vit janë në vlerën 1.147.454 lekë. Shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për këtë vit përfshijnë shpenzimet e jetesës, shpenzimet për mobilim, studim dhe shpenzimet për biznesin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë qenë në vlerën 970.000 lekë. Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare është në vlerën -105.226,64 lekë, ndërsa kursimi *cash* sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit është në vlerën 500.000 lekë. Nga raporti të ardhura minus shpenzime dhe diferencës së likuiditeteve rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte kursime në vlerën 500.000 lekë, por mund të kursente vetëm 282.680,64 lekë, sepse diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton të jetë negative në vlerën 217.319,36 lekë.

---

<sup>16</sup>Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 10/2019(JR), datë 18.04.2019, paragrafi nr. 13.3; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafët 67.2 dhe 67.3.



**29.3** Në DIPP-në e vitit 2011, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtuar kursime të deklaruara në deklaratën e vitit 2011, në shumën 1.500.000 lekë (një milion e pesëqind mijë lekë K.E.SH.) Burimi i të ardhurave nga paga si prokurore dhe e bashkëshortit. Kolegji vëren se gjendja e llogarive bankare në fillim të vitit 2011 rezulton 13.600,74 lekë, ndërsa në fund të vitit gjendja e llogarive bankare është 139.079,99 lekë. Përlllogaritja e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj është kryer duke u bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje nga institucionet përgjegjëse. Të ardhurat e vitit 2011 për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj kanë qenë në total në vlerën 1.274.227 lekë. Nga sa më sipër, kuptojmë se të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit nuk mjaftojnë për të krijuar kursimet e deklaruara në vlerën 1.500.000 lekë.*

**29.4** Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë likuiditete, nga sa rezultoi e provuar në Kolegji, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara, për pasojë nuk ka pasur mundësi të blinte apartamentin me sipërfaqe 59,2 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, duke qenë se shtesat e cash-it të deklaruara në vitet 2010 dhe 2011 nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme.

**30. Lidhur me transaksionin e padeklaruar prej 25.000 eurosh,** Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar një marrëdhënie huaje në shumën totale prej 25.000 eurosh në DIPP-në e vitit 2011. Po ashtu, nuk është deklaruar edhe kthimi i shumës 25.000 euro në DIPP-në e vitit 2014, hua e cila i rezultoi ILDKPKI-së gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për efekt të rivlerësimit sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**30.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë transaksion: *Është deklaruar dhe dokumentuar nga hetimi se shtetasi A.P. ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe nga burim i ligjshëm për dhënien e kësaj huaje shtetasit R.N. (administrator i shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK), ku V.P. ka qenë i punësuar. Huadhënia nuk është deklaruar, pasi nuk ka qenë pjesë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.*

**30.2** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje huaje nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar kur ILDKPKI-ja është vënë në dijeni nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim “DPPPP”), e cila me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, ka referuar se për z. V.P. ka raportime për transaksione bankare, ku një ndër ta është identifikuar një tërheqje *cash* në shumën 5000 euro, më datë 19.06.2014 dhe 20.000 euro më datë 20.06.2014, në llogarinë e tij pranë Alpha Bank. Kjo e fundit i ka referuar ILDKPKI-së se z. R.N. (një ndër ish-punëdhënësit e V.P.), administrator i shoqërisë “{\*\*\*}”, ka pasur kontratë borxhi. Kësaj shoqërie i është miratuar një kredi nga Alpha Bank dhe disbursimi i limitit të saj do të shërbente për të mbyllur ekspozimet që ka pasur shoqëria. Disbursimi i kredisë do të kryhej nga banka direkt në llogarinë e palëve të treta, për të shmangur riskun e ndonjë gabimi operacional, si

dhe që kredimarrësi të mos e përdorte këtë kredi jashtë objektit të përcaktuar në kontratë. Shtetasi V.P. nuk ka qenë vetë kredimarrës, por ka qenë përfitues i një shume nga kredia e miratuar nga kjo bankë për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me administrator z. R.N., sipas marrëveshjes së kontratës së borxhit.

**30.3** Nga dokumentacioni i administruar në dosje vërehet se në korrespondencën me ILDKPKI-në, Alpha Bank ka vënë në dispozicion këto dokumente: (i) deklaratë shkresore e datës 22.09.2011, nënshkruar nga R.N. dhe V.P., ku R.N. deklaroi se i ka marrë hua në datën e nënshkrimit të kësaj deklaratë V.P. shumën 15.000 euro, për një periudhë njëvjeçare, me interes mujor 2%. Deklarimet e kësaj shkrese nuk janë bërë para noterit, por nënshkrimet në këtë deklaratë janë vërtetuar sipas ligjit nga noteri publik, më datë 31.10.2013 (rep. dhe kol. të vërtetimit nënshkrimit janë të palexueshëm); (ii) deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2011, të deklaruesve R.N. dhe V.P., ku z. N. deklaroi se “marr hua me datën e sotme nga V.P. shumën 10.000 euro, për një periudhë njëvjeçare, duke filluar nga data e sotme, 14.09.2011 dhe deri më 14.09.2012, me një interes mujor në masën 2%”; (iii) marrëveshje shtesë e Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.06.2014, ndërmjet Alpha Bank në cilësinë e kredidhënësit dhe z. R.N. në cilësinë e kredimarrësit.

**30.4** Komisioni ka pyetur edhe subjektin e rivlerësimit në pyetësin nr. 3, mbi burimin e shumës së dhënë hua prej 25.000 eurosh dhe dokumentimin e kësaj marrëdhënieje huaje. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Për sa i përket huas që bashkëshorti im ka dhënë në vitin 2011 shtetasi R.N., në shumën 25.000 euro, pasi u njoha me pyetjen e bërë nga ana juaj, nga komunikimi me bashkëshortin V.P., erdha në dijeni se këtë shumë bashkëshorti im e ka dhënë hua duke vepruar si përfaqësues me prokurë i shtetasit A.P., kushëriri i tij. Kjo shumë nuk është pasuri e cila i përket bashkëshortit tim, V.P., apo na përket ne si familje. Konkretisht, për shkak të marrëdhënies së posaçme punëdhënës - punëmarrës që bashkëshorti ka pasur me shtetasin R.N. si administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2011 shtetasi R.N. dhe shtetasi A.P., djali i xhaxhait të bashkëshortit, kanë biseduar që ky i fundit t’i jepte hua shumën 25.000 euro.*

**30.5** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në mbështetje të përgjigjes së pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit këto dokumente: (i) prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.07.2011, me anën e së cilës A.P. ka caktuar si përfaqësues ligjor të tij z. V.P.; (ii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2018, e z. A.P., sipas së cilës shumën prej 25.000 eurosh e ka marrë me dy këste në dy periudha të ndryshme, personalisht nga R.N., bashkë me interesin e përcaktuar prej 2% në muaj; (iii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2018, e shtetasit R.N. Nëpërmjet këtij akti ky i fundit deklaroi se, meqenëse ndodhej në një situatë të vështirë financiare, ka diskutuar me inxhinierin (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i cili ka punuar drejtor teknik në shoqërinë {\*\*\*} për periudhën 2011-2014) për të gjetur hua. Dy muaj para se të bëheshin deklaratat noteriale, në korrik, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka takuar qytetarin R.N. me djalin e xhaxhait të tij, A.P.,

emigrant, i cili kishte ardhur me pushime në Shqipëri. A.P. i kishte ofruar t'i jepte hua 25.000 euro, por fakti që ishte jashtë shtetit, nuk kishte garanci kthimi të shumës, si dhe 2% interesin mujor. Për këtë ka dalë garant V.P.

**30.6** Lidhur me këtë transaksion, në parashtrimet e datës 17.07.2020, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: *Në lidhje me pretendimin për mosdeklarim të huas së sipërcituar, sqaroj se kjo hua nuk është deklaruar në deklaratimet periodike vjetore nga ana e bashkëshortit dhe në deklaratën "vetting" 2017, për shkak se kjo shumë dhe marrëdhënia juridike që ka ekzistuar midis bashkëshortit dhe subjekteve nuk lidhet me pasurinë tonë dhe detyrimet tona personale si familje dhe, si e tillë, bashkëshorti, si person i lidhur i subjektit të rivlerësimit, nuk mbart detyrimin për deklarim për këtë lloj marrëdhënieje [...]. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, kjo shumë nuk i përkiste asaj dhe bashkëshortit të saj, por ishte një hua mes A.P. dhe R.N. Në këtë marrëdhënie, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shërbyer vetëm si përfaqësues me prokurë i shtetasit A.P. Sa i përket burimit të shumës së dhënë hua, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj disa dokumente të përkthyer dhe noterizuara me vulë apostile, mbi qëndrimin dhe punësimin e shtetasit A.P. në shtetin italian, si dhe të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij nga punësimi në këtë shtet, prova këto, të cituara në pikat 22.22 deri 22.28 të këtij vendimi.*

**30.7** Komisioneri Publik, në parashtrimet e datës 27.07.2020, pretendoi se nuk është provuar e kundërta nga prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Komisioneri Publik u shpreh se, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë detyrimin të deklarojnë pasuritë e luajtshme, interesat privatë, të krijuar sipas parashikimeve të dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

**30.8** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, sipas prokurës së posaçme të vitit 2011, V.P. është caktuar si përfaqësues i posaçëm që të veprojë në emër dhe për llogari të shtetasit A.P., duke i përcaktuar në mënyrë të posaçme dy detyra, saktësisht për lidhjen e kontratave të huas me R.N., si dhe të marrë interesat mujore prej 2%, sipas marrëveshjes në emër dhe për llogari të A.P. Ndërsa vetë A.P., në deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2018, ka deklaruar se shumën prej 25.000 eurosh e ka marrë me dy këste, në dy periudha të ndryshme dhe e ka marrë personalisht nga R.N., bashkë me interesin e përcaktuar prej 2% në muaj. Nga ana tjetër, rezulton se shuma prej 20.000 eurosh është konfirmuar nga Alpha Bank dhe DPPPP se është transaksion i V.P. Vërehet një mospërputhje ndërmjet detyrave të lëna nëpërmjet prokurës së posaçme dhe deklaratës noteriale, ku A.P. deklaroi se eurot i ka marrë personalisht nga R.N. Gjithashtu, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe palët deklaruese në asnjë moment nuk deklarojnë faktin se huadhënësi V.P. po vepron në emër të z. A.P., sikurse është përcaktuar në tagrat e prokurës së posaçme të korrikut 2011.

**30.9** Në DIPP-në e vitit 2011, nuk rezulton që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ta këtë deklaruar këtë marrëdhënie huaje ndaj shtetasit R.N., burimin e saj, prokurën e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.07.2011, që z. A.P. e ka caktuar si përfaqësues të posaçëm që të veprojë në emër dhe për llogari të tij, në lidhje me dhënien hua në shumën prej 25.000 eurosh, me

interes mujor prej 2%. Po ashtu, as në DIPP-në e vitit 2014 nuk është deklaruar tërheqja e shumë prej 25.000 eurosh nga Alpha Bank. Rezulton se edhe në deklaratën *vetting*, kjo marrëdhënie huaje dhe prokura e posaçme e vitit 2011 nuk janë deklaruar. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, Komisioni ka gabuar kur në paragrafin nr. 95 të vendimit ka arsyetuar: *[..] Këto veprime, z. V.P. i ka kryer me prokurën e posaçme të datës 15.07.2011, të deklaruar në DPV përkatës [..].*

**30.10** Kolegji çmoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ky transaksion nuk i përkiste asaj dhe bashkëshortit të saj dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar, nuk e zhvesh subjektin e rivlerësimit nga detyrimi që ka pasur për deklarime të sakta, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por edhe të vetë ligjit nr. 84/2016. Dinamika e veprimeve në lidhje me këtë transaksion, nuk e përjashton bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit nga përfshirja në të, pasi në deklaratat shkresore të R.N. të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezulton si huadhënës dhe nuk përmendet se vepron për llogari të kushëririt A.P., sipas detyrave të lëna nga prokura e posaçme e vitit 2011. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë që vetë A.P. ka deklaruar se kthimin e huas e ka marrë nga R.N., ndërkohë që shuma prej 25.000 eurosh është tërhequr në bankë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, janë të gjitha veprime dhe rrethana të cilat plotësojnë kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Siç rezulton edhe nga analiza financiare e detajuar në paragrafin 29.3 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 rezulton me diferencë negative sa u përket të ardhurave nga burime të ligjshme, për pasojë gjendet në pamundësi të burimeve financiare të ligjshme për të financuar shumën prej 25.000 eurosh të dhënë hua.

**30.11** *Si rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se kjo shumë është pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të. Për këtë pasuri, rezultoi se ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e saj dhe është kryer fshehje pasurie në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.*

- 31. Lidhur me transaksionin bankar/pagesë cash në shumën 1.755.000 lekë,** kryer nga z. V.P., Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar një transaksion bankar të datës 24.04.2013, në shumën 1.755.000 lekë, i kryer pranë Bankës Kombëtare të Greqisë, transaksion që i rezultoi ILDKPKI-së gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit për efekt të rivlerësimit, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**31.1** Kolegji vëren se ILDKPKI-ja është vënë në dijeni nga DPPPP-ja, e cila me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, ka referuar se për z. V.P. ka raportime për transaksione bankare, ku një ndër ta është identifikuar një kreditim llogarie në shumën 1.755.000 lekë, më datë 24.04.2013, në llogarinë e tij pranë Bankës Kombëtare të Greqisë. Burimi i të ardhurave të deklaruara për efekt të transaksionit është shënuar “shitja e apartamenteve”. Më tej, shkresa vijon: *Veprimet janë kryer në sportelin e Bankës pranë ZRPP Durrës dhe qëllimi i transaksionit ka qenë regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja të firmës “{\*\*\*}” ShPK [...], në një kohë që marrëdhënia e*

punës me këtë firmë kishte përfunduar që në vitin 2011, konfirmuar nga vetë z. F.B. në shkresën e dërguar Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.09.2018. Ky veprim është kryer ndërmjet z. V.P. dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Nga sqarimi që ZRPP Durrës ka dhënë për DPPP, në lidhje me qëllimin e transaksionit, rezulton se ka qenë për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja të firmës “{\*\*\*}” ShPK, për 195 njësi, në vlerën 1.267.500 lekë, lëshim vërtetim pronësie për 195 njësi në vlerën 292.500 lekë, si dhe lëshim hartash treguese për 195 njësi në vlerën 195.000 lekë, të cilat bëjnë totalin e transaksionit prej 1.755.000 lekësh.

**31.2** Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.07.2020, të zhvilluar në Kolegj, ka parashtruar se: *[...] Nga aktet e administruara, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri, provohet lidhja, shkaku ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti, pranë Z.V.R.P.P-Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë ishin ndërprerë prej dhjetorit të vitit 2011 [...].*

Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: *pagesa e shumës 1.775.000 lekë për regjistrimin përfundimtar të objektit për llogari të “{\*\*\*}” ShPK në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, nga të ardhurat e kompanisë {\*\*\*} ShPK, është një tregues tjetër që bashkëshorti ka vazhduar komunikimin dhe kryerjen e punëve të ndryshme për llogari të kompanisë, pikërisht për këtë objekt për të cilin ai kishte interes të ligjshëm, përfitim të apartamentit sipas marrëveshjes verbale midis palëve [...]. Në këtë seancë gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dorëzoi disa prova lidhur me këtë shkak ankimi, të cilat janë cituar në pikat 22.17 deri 22.21 të këtij vendimi.*

**31.3** Komisioneri Publik në parashtrimet e seancës gjyqësore në Kolegj, më datë 27.07.2020, i qëndroi vlerësimit se nuk provohet lidhja, shkaku ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë ZVRPP Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK ishin ndërprerë prej nëntorit të vitit 2011. Komisioneri Publik çmoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur si i vetmi veprim juridik i provuar kreditimi i një vlere prej 1.755.000 lekësh nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, veprim ky i padeklaruar në deklaratat vjetore dhe në deklaratën *vetting*.

**31.4** Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se më datë 24.04.2013, sqarohet nga DPPP-ja që transaksioni është kryer ndërmjet V.P. dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Burimi i të ardhurave është deklaruar në bankë nga shitja e apartamenteve dhe veprimet janë kryer në sportelin e bankës pranë ZRPP Durrës. Nga dokumentacioni i ZRPP-së, rezulton se qëllimi i transaksionit ka qenë regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për 195 njësi, lëshim vërtetim pronësie, si dhe lëshim harte treguese, të cilat arrijnë në një vlerë totale prej 1.755.000 lekësh, aq sa rezulton edhe transaksioni i kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Nisur nga rrethanat e faktit dhe dokumentacioni i administruar në dosje, trupi gjykues

i Kolegjit krijoi bindjen lidhur me veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit se qëllimi i këtij transaksioni është qartësuar dhe provuar me dokumentacionin që është administruar në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, si rrjedhojë shkaku i ankimit të Komisionerit Publik nuk gjendet i bazuar.

### **Vlerësimi i aftësive profesionale**

32. Komisioneri Publik pretendoi nëpërmjet ankimit se, në zbatim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, ka konstatuar se për dy nga pesë dosjet penale të përzgjedhura, dy çështje të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit (dosja nr. 4 dhe 5) që kanë pasur për objekt të njëjtën veprë penale, atë të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, janë ndjekur standarde të ndryshme hetimi dhe procedimi. Në rastin e dosjes nr. {\*\*\*}, për të pandehurin G.K. është proceduar në kushtet e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa për dosjen nr. {\*\*\*}, i pandehuri V.S., për të njëjtën veprë penale, është proceduar në gjendje të lirë, pa u kërkuar masë sigurimi nga ana e prokurorisë.

32.1 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, i cili ka vërejtur se janë aplikuar dy standarde të ndryshme në lidhje me vërtetimin e legjitimitetit të arrestit, si dhe kërkesës për burgim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Në lidhje me konstatimin e Komisionit për aplikimin e dy standardeve për trajtimin e dy rasteve të njëjta, sqaroj se ky konstatim nuk qëndron. (I) Referuar akteve të procedimit penal ndaj shtetasit G.K. rezulton se ai është arrestuar nga policia gjyqësore me procesverbalin e datës 06.06.2015, për veprën penale “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Arrestimi i tij është bërë në kushtet e flagrancës, duke drejtuar mjetin motorik në gjendje të dehur (nga aktet ka rezultuar se ky shtetas nuk posedonte as leje drejtimi).

(II) Shtetasi V.S., referuar akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, është referuar nga policia në gjendje të lirë për veprën penale “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Sipas procesverbalit të kapjes së këtij shtetasi, datë 27.06.2014, ai është kapur duke drejtuar mjetin motorik pa leje drejtimi”.

Subjekti i rivlerësimit vazhdon shpjegimin: “Standardi i dyfishhtë është ndjekur nga policia dhe jo nga prokurori, pasi shtetasin G.K. e kanë sjellë për hetim të arrestuar, ndërsa shtetasin V.S. në gjendje të lirë. Procesverbalin e kapjes në flagrancë, për rastin e shtetasit V.S., është një akt procedural i përpiluar nga policia, që bazohet në nenin 252 të K.Pr.Penale. Neni 258 i K.Pr.Penale parashikon që prokurori paraqet kërkesë për vlerësimin e arrestit në flagrancë brenda 48 orëve nga arrestimi i tij. Arrestimi në flagrancë pasqyrohet në procesverbalin e arrestimit në flagrancë që mban policia dhe jo në procesverbalin e kapjes në flagrancë. Kjo do të thotë se për të pasqyruar gjendjen e flagrancës, policia përpilon procesverbalin e kapjes në flagrancë të personit, i cili nuk është i njëjtë me procesverbalin e arrestimit në flagrancë të tij, që do të thotë se një person mund të kapet në flagrancë për kryerjen e një veprë penale dhe, në varësi të rëndësisë së faktit (referoju

nenit 251 të sipërcituar), mund të arrestohet në flagrancë ose jo nga policia. Kjo ka ndodhur në rastin e shtetasit V.S., pasi policia ka kryer kapjen e tij në flagrancë, duke e pasqyruar në procesverbalin e kapjes në flagrancë, por nuk ka kryer arrestimin në flagrancë të tij. Në këtë rast, personi është sjellë për ndjekje penale, për fillim të hetimeve në gjendje të lirë dhe jo i arrestuar, gjë që do të sillte detyrimin tim si prokurore për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesë për vlerësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, sikurse kërkon neni 258 i K.Pr.Penale ose të vlerësoja të paligjshëm arrestimin në flagrancë të personit dhe të urdhëroja lirimimin e tij të menjëhershëm, bazuar në nenin 257 të K.Pr.Penale. Sa më sipër, rezulton se në rastin konkret nuk janë zbatuar standarde të ndryshme për raste të ngjashme, pasi për shtetasin V.S. nuk gjen zbatim dispozita e nenit 258 të K.Pr.Penale”.

**32.2** Kolegji vëren se neni 251 i K.Pr.Penale, me titull “Arrestimi në flagrancë” parashikon se:

*1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.*

*2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.*

*3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.*

*4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij.*

Sipas pikës 1 të këtij neni, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore **kanë detyrim për arrestim** në rast të kapjes në flagrancë të personave që kryejnë krime, për të cilat marzhi maksimal i dënimit është përcaktuar sipas kësaj pike. Ndërsa sipas pikës 2 të nenit cituar më sipër, oficerët dhe agjentët **kanë të drejtë të arrestojnë**, sipas kushteve të përcaktuara sipas kësaj pike, pra nuk janë të detyruar si në pikën 1. Kjo e drejtë arrestimi duket që është e lidhur me maksimumin e dënimit për veprën penale, e cila nuk duhet të jetë më e ulët se 2 vjet. Në rastin konkret, vepra penale e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, parashikon maksimumin e dënimit 3 vjet, çka e bën të përfshihet në pikën 2 të nenit 251 të K.Pr.Penale, sipas të cilit agjentët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë. Po kështu, edhe sipas pikës 3, në raste domosdoshmërie, kur diktohet rrezikshmëri e subjektit (autorit), **e motivuar me akt të veçantë, kanë të drejtë arrestimi** edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2. Pra, siç vërehet në pikat 2 dhe 3 të nenit 251 të

K.Pr.Penale, lihet në diskrecionin e autoriteteve të përcaktuara të ky nen, për arrestimin e cilitdo që kapet në gjendje flagrante<sup>17</sup>.

**32.3** Kolegji konstaton se për shtetasin V.S., që i përket procedimi penal nr. {\*\*\*}, i cili është kapur të drejtonte mjet motorik pa leje drejtimi, rezultoi se policia ka plotësuar vetëm procesverbal të kapjes në flagrancë dhe jo procesverbal arrestimi në flagrancë, duke e çuar për hetim në gjendje të lirë. Ndërsa për G.K., të cilit i përket procedimi penal nr. {\*\*\*}, policia ka lëshuar procesverbal të kapjes në flagrancë, si dhe procesverbal arresti në flagrancë, pasi kishte drejtuar mjetin në gjendje të dehur dhe pa leje drejtimi. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës me kërkesë për vlerësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, sikurse kërkon neni 258 i K.Pr.Penale. Ndërsa për shtetasin V.S., i cili është dërguar për hetim nga policia në gjendje të lirë dhe nuk kishte të plotësuar procesverbal arrestimi në flagrancë, nuk mund të aplikohet neni 258 i K.Pr.Penale për vlerësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit.

**32.4** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë shkak ankimi, ka parashtruar në seancën e datës 17.07.2020, se standardi i dyfishtë në këtë rast është ndjekur nga policia dhe jo nga ana e saj si prokurore, pasi shtetasin G.K. e ka sjellë për hetime të arrestuar, ndërsa shtetasin V.S. në gjendje të lirë. Në këtë rast, parashtron më tej subjekti i rivlerësimit, nuk ka ndjekur standarde të ndryshme për raste identike, pasi për shtetasin V.S. nuk gjen zbatim dispozita, neni 258 i K.Pr.Penale. Subjekti i rivlerësimit gjatë kësaj seance, lidhur me këtë shkak ankimi, dorëzoi provat e listuara në pikat 22.36 deri 22.39 të këtij vendimi.

**32.5** Komisioneri Publik, në parashtrimin e tij të datës 27.07.2020, vlerësoi se përgjegjësia mbi mënyrën dhe veprimet procedurale të hetimit i përket prokurorit dhe ky i fundit kurrsesi nuk lidhet me referimin e oficerëve të policisë gjyqësore, i drejtë apo i gabuar qoftë ai. Referuar nenit 148 të Kushtetutës, ligjit material dhe atij procedural penal në fuqi, prokurori është i vetmi autoritet ligjor të cilit i njihet e drejta e ushtrimit dhe ndjekjes penale; dhe veprimtaria ndihmëse e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore, në këtë rast, nuk kushtëzon vlerësimin dhe kontrollin e prokurorit. Përkundrazi, është ky i fundit, ai i cili udhëheq dhe vlerëson mbi bazën e ligjit dhe të faktit, veprimtarinë procedurale hetimore dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit.

**32.6** Trupi gjykues i Kolegjit çmoi në vazhdim të analizës, se pikënisja e plotësimit të procesverbalit për kapjen në flagrancë, si dhe të procesverbalit për arrestimin në flagrancë është atribut i oficerëve dhe agjentëve policorë, të cilët sipas pikës së parë të nenit 252 të K.Pr.Penale e kanë detyrim arrestimin në flagrancë, ndërsa për pikat 2 dhe 3 të këtij neni kanë të drejtë arrestimi, çka do të thotë që vlerësohet në varësi të rrethanave edhe arrestimi në flagrancë, siç është rasti i

---

<sup>17</sup> Neni 252 i K.Pr.Penale "Është në gjendje flagrante ai që është kapur: (1) në kryerje e sipër të veprës penale ose (2) ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, ose (3) që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.



V.S., ku edhe pse në gjendje flagrante, pasi është kapur pa leje drejtimi, policia e ka çuar për hetim në gjendje të lirë. Ndërsa në rastin tjetër krahasimor, policia e ka dërguar për hetim me procesverbal arrestimi në flagrancë, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sipas nenit 258 të K.Pr.P. vleftësimin e arrestit, si dhe caktimin e masës së sigurimit, pasi ky shtetas (G.K.) është kapur nga policia, përveçse pa leje drejtimi, në gjendje të dehur, si dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, i cili pasi ka ndaluar një makinë në rrugë duke pretenduar se e ka rrëzuar ai (është drejtuesi i makinës që ka bërë kallëzimin), i ka lënë në ngarkim motorin dhe është larguar, pak minuta më pas është ndaluar nga policia. Këto sjellje përbëjnë një rrezik potencial më të madh shoqëror dhe, si pasojë, rrethanat e kryerjes së veprës penale lënë vend për të dyshuar largimin e autorit të veprës, duke e përlligjur kështu edhe arrestimin e tij. Gjithashtu vepra penale që parashikohet nga neni 291 i Kodit Penal ka një maksimum dënimi deri në 3 vjet, që do të thotë se jo domosdoshmërisht futet te veprat për të cilat është detyrim arrestimi në flagrancë, sipas pikës 1 të nenit 252 të K.Pr.Penale.

**32.7** Kolegji çmoi se subjekti i rivlerësimit, përveç sa ka shpjeguar se V.S. është sjellë nga policia në gjendje të lirë, mund të kishte kërkuar vetë masë sigurimi në gjykatë, nëse nuk do të ishte dakord që ky qytetar të hetohej në gjendje të lirë. Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar masë sigurimi, nuk rezulton të jetë rezultat i zbatimit të një standardi të dyfishtë, pasi rrethanat në të cilat ndodhet secili i autor i veprës penale apo rrethanat në të cilat është kryer vepra penale janë vendimtare. Të dyja këto raste duken të ngjashme për shkak se bëhet fjalë për të njëjtën veprë penale, por rrethanat e kryerjes së veprës janë të ndryshme, pasi njëri prej tyre ka qenë edhe në gjendje të dehur, përveçse pa leje drejtimi, si dhe ka tentuar të largohet, duke paraqitur kështu rrezikshmëri më të lartë shoqërore, rrethana të cilat diktojnë nevojën për arrestimin dhe masën e sigurimit personal.

**32.8** Neni 228 i K.Pr.Penale, me titull “Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal”, në pikën 3, shkronja “b”, parashikon: *Masat e sigurimit personal vendosen kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet.* Gjithashtu, neni 230 i K.Pr.Penale, me titull “Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit me burg”, në pikën 1 të tij parashikon: *Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.* Këto dispozita janë të lidhura me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore etj., ndaj dhe në veprat penale parashikohet marzhi i dënimit dhe jo masa e sigurimit personal, pasi kjo është e lidhur kryesisht me personin që e kryen veprën penale, rrezikshmërinë e tij shoqërore, si dhe rrezikun për t’iu shmangur drejtësisë, për këtë shkak vlerësohet rast pas rasti.

**32.9** Në përfundim të analizës, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vepra penale mund të jetë e njëjtë, por rrethanat e kryerjes së saj diktojnë rrezikshmërinë, si dhe nevojën për arrestimin dhe vendosjen e masës së sigurimit personal. Bazuar në dokumentacionin që ndodhet në dosjen profesionale dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk janë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, rezultoi se trajtimet e rasteve janë të ndryshme, për shkak se rrethanat janë të ndryshme, për arsye që u shpjeguan më sipër gjatë

analizës. Komisioni, me të drejtë, ka konkluduar se veprimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto dy çështje janë në përputhje me ligjin. Për pasojë, shkak i ankimit të Komisionerit Publik, në lidhje me dy dosjet penale, se për to ka elemente që duhen konsideruar në vlerësimin tërësor të procedurave sipas neneve 4, pika 2 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar në ligj e në prova.

33. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në referencë të sjelljes së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpunimit gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik vlerësoi se të dyja rastet e kërkesave për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.07.2020, duhen konsideruar si një përpjekje për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit, sjellje e cila duhet të merret parasysh nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit bashkëpunimi dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit me Kolegjin, është faktor me rëndësi në vendimmarrjen gjatë procesit. Komisioneri Publik vlerësoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit duhet të vlerësohet nga Kolegji në analizë të vlerësimit etiko-profesional, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 48 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

33.1 Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se, nëse këto kërkesa janë abuzive dhe joligjore, nuk mund të përcaktohen në gjykimin e themelit, por nga trupat gjykuese që kanë shqyrtuar kërkesat. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se trupi gjykues që gjykon themelin e çështjes nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit për kërkesat e saj, që kanë të bëjnë pikërisht me legjitimitetin e trupit gjykues që po e gjykon subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bashkëpunimi dhe sjellja e saj gjatë gjyqimit nuk nënkuptojnë ndalimin për të bërë çdo kërkesë që e vlerëson të drejtë dhe ligjore, në përmbushje të të drejtave të subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, por ka të bëjë me gatishmërinë e tij për të paraqitur prova, fakte e të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me procedurën e rivlerësimit, pa u përpjekur të zvarritë procesin.

33.2 Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se argumentet që paraqiti Komisioneri Publik lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit gjyqësor, pavarësisht se u konstatuan disa prej tyre nga vetë Kolegji, nuk gjejnë vend për t'u trajtuar në kuadrin e vlerësimit të përgjithshëm, sipas kërkesave të nenit 4, pika 2 në lidhje me nenin 48 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kërkesat e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të përmbushjes së të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të bazuara në nenin 27, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk u konsideruan si mungesë bashkëpunimi, pasi subjekti i rivlerësimit paraqiti dy kërkesa për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, të cilat u shqyrtuan rregullisht nga dy trupa të tjerë gjykues.

34. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në seancë publike për subjektin e rivlerësimit, znj. Donika Prela, Komisioneri Publik, në diskutimet përfundimtare të datës 18.09.2020, vlerësoi se: *për kriterin e pasurisë*, në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke përfunduar për kontrollin e kriterit të pasurisë me një diferencë negative, vlerësoi

se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, të paplotë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016; *për kriterin e aftësive profesionale dhe nga vlerësimi tërësor i çështjes*, në interpretim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e këtij ligji. Bazuar në dispozitën e pikave 3 dhe 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi nga ana e Kolegjit të vendosë:

*Ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela.*

**34.1** Subjekti i rivlerësimit, znj. Donika Prela, në seancën e datës 18.09.2020, përfaqësuar në mungesë nga avokatja e saj Blerina Dodaj, në përfundim të konkluzioneve përfundimtare në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 kërkoi nga Kolegji:

*Të mos marrë në konsideratë shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për vendimin nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë si prokurore dhe të vendosë lënien në fuqi të vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë.*

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme,  
arriti në këto konkluzione:**

- I. **Për vlerësimin e pasurisë.** Në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 95,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- II. Në lidhje me pasurinë likuiditete, në shumën 4.501.427,89 lekë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- III. Në lidhje me transaksionin e huadhënies në shumën 25.000 euro, Kolegji arriti në konkluzionin se kjo shumë është pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të. Për këtë pasuri, rezultoi se ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e saj dhe është kryer fshehje pasurie në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.

Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë vendimi i Komisionit nr. 103, datë 05.02.2019, me të cilin është vendosur

konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 05.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, dhe shkarkimin e saj nga detyra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 25.07.2020, ora 10:00, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*